



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:135822

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05685420

P.nr.61/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, përmes gjyqtarit Sadri Krasniqi, me zyrtaren ligjore Donjeta Zenuni, në lëndën penale kundër të pandehurve; E. Q. nga dhe L. Sh. nga, për shkak se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale, kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i pikës kufitare nga neni 140 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-ës, në Gjilan, PP.II.nr.618/2024, të datës 10.05.2024, duke vendosur sipas kërkesës së PTH-së në Gjilan, për dhënien e Urdhrit ndëshkimor, më datë 15.05.2024, hartoi dhe publikoi këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-ës nga Gjilani PP.II.nr.618/2024, të datës 10.05.2024, për dhënien e Urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurve,

1.E. Q., nga babai A. dhe nëna V. , e lindur B., i lindur më dt..... në, me i me profesion, i, me gjendje të,,,, me nr. personal të përkohshëm të Rep. së Kosovës, dhe

2.L.Sh., nga babai B. dhe nëna A. e lindur S., i lindur më dt..... në,, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor fizik, me gjendje të varfër ekonomike, shqiptar , shtetas i Rep . së, me nr. pers, të

J a n ë f a j t o r ë

S e p s e:

Me datë 17.04.2024, rreth orës 20.05h, nga për në fshatin në fshatin, jashtë vendkalimit të autorizuar kufitar,të pandehurit kanë hy në territorin e Republikës së Kosovës,

rrugëve malore, duke shmangur pikën e rregullt kufitare, në atë mënyrë që përderisa patrulla e SPMK Muçivërc, po patrullonte në zonën e përgjegjesisë të brezit kufitar ndal veturën me targa R AS2500 që po e drejtonte i pandehuri L.Sh. ndërsa pasagjer ishte i pandehuri E. Q., pas legjitimitit të personave dhe veturës vërtetohet se të pandehurit paraprakisht kishin provuar të hynin përmes pikës kufitare në Muçibabë dhe Dheu i Bardhë por nuk u ishte lejuar për shkak se vetura nuk kishte regjistrim dhe përkundër se të vetëdijshëm se vetura nuk kishte regjistrim, të pandehurit për të shmangur ndalesën, hyjnë në Republikën e Kosovës nga, jashtë vendkalimit të autorizuar kufitar duke shmangur pikën e rregullt kufitare .

-Me çka në bashkëveprim kanë kryer veprën penale, kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i pikës kufitare nga neni 140 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 38, 43, 69 dhe 70 të KPRK-ës, si dhe nenit 364 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurit e lartcekur i,

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej **nga 150 € (njëqind e pesë dhjetë euro)**, të cilën gjobë të pandehurit kanë për ta arkëtuar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën, nëse të pandehurit nuk e arkëtojnë dënimin me gjobë në afatin prej 15 ditëve, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që çdo ditë burgu do të llogaritet në shumë prej 20 €.

Të pandehurve u kthehen sende e sekuestruara përkohësisht sipas Vërtetimit mbi marrjen e përkohshme të mallit me nr. 2024-YED-027 të datës 17.04.2024, edhe ate të pandehurit, E. Q., Leje qëndrimi e RKS, me nr. personal, lëshuar nga MPB në Prishtinë më 14.06.2022, ndërsa për të pandehurin L.Sh., Patentë shoferi me nr....., lëshuar në Bujanoc.R. e Serbisë.

Obligohen të pandehurit, që në emër të paushallit gjyqësor ta arkëtoj shumën prej nga 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të përgjithshme, më datën 10.05.2024, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.618/2024, kundër të pandehurve: E. Q. nga dhe L. Sh.nga për shkak se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale, kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i pikës kufitare nga neni 140 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndaj të cilëve ka paraqitur edhe kërkesën për dhënien e Urdhrit ndëshkimor dhe ka kërkuar që të pandehurve të iu shqiptohet dënime me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 493 parag. 2, lidhur me parag.1 të KPPRK-së.

Gjykata shqyrtoi dhe analizoi aktakuzën, Kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës dhe konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e PTH-së, për dhënien e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurve dhe të njëjtëve t’iu shqiptohet dënime me gjobë.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në aktin e akuzës siç janë: deklaratat e të pandehurve E. Q. dhe L.Sh., raporti i oficerit Nexhip Ahmetaj i dt.18.04.2024, Vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt.17.04.2024, ekstrakti penal i të pandehurve, Aktvendimi i dt.19.04.2024 me nr.03.1.7-2024-504, procesverbal mbi kundërvajtjen administrative doganore lidhur me veturën, emaili i dt.17.04.2024 nga PKK Muçibaba, email i dt.07.05.2024 nga PKK Dheu i Bardhë, dokumente personale të pandehurve, si dhe shkresat tjera në lëndë, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor me bindje se edhe këto dënime të shqiptuara do të ndikojnë tek të pandehurit dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, prandaj e aprovoi kërkesën e PTH-së nga Gjilani, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe të pandehurit i shpalli fajtor dhe iu shqiptoi dënime me gjobë.

Të pandehurve u kthehen sende e sekuestruara përkohësisht sipas Vërtetimit mbi marrjen e përkohshme të mallit me nr. 2024-YED-027 të datës 17.04.2024, edhe ate të pandehurit, E. Q., Leje qëndrimi e RKS, me nr. personal, lëshuar nga MPB në Prishtinë më, ndërsa për të pandehurin L.Sh., Patentë shoferi me nr..... lëshuar në Bujanoc.R. e Serbisë.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurve, e në pajtim me dispozitat e nenit 452, lidhur me nenin 449, paragrafi 2, pika 2.6 e KPPRK-së, gjykata ka vendosur që të pandehurit ti obligoj për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 € (Njëzetë euro), në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2024:135822, 15.05.2024

G j y q t a r i

Sadri Krasniqi,d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi- urdhrit ndëshkimor mundë të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, kundërshtimi i paraqitet kësaj gjykate, e pastaj gjykata do të caktoj seancën për shqyrtim kryesor në pajtim me nenin 496 parag. 4 i KPPRK-së.